



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

**AKADEMIA TEATRALE 2023**

**Thirrje për pranim**

**STRUKTURA**

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), në bashkëpunim me Qendrën “Gjenerata e re”, ka iniciuar programin e parë profesional muzikor në Shqipëri, Akademia Teatrale.

Një projekt i ndërtuar në kuadër të promovimit, zhvillimit dhe perfeksionimit të teknikës në disiplinën lirike, mbi bazën e përvojave më të suksesshme ndërkombëtare, me në fokus të rinjtë shqiptarë e të huaj dhe fuqizimin e potencialit të tyre, në skenën e TKOBAP-së dhe përtej saj.

Nëpërmjet kësaj strukture ndërveprimi mes artistësh profesionistë siç është Akademia Teatrale, të rinjve do t’u krijohet mundësia të bëhen pjesë e masterclass-ve, nën kujdesin e veçantë dhe mjeshtëror të figurave artistike prestigjioze, si dhe të marrin mësim individual nga mësues dhe artistë të njohur ndërkombëtarë.

Çdo kandidati fitues do t’i jepet mundësia që të marrë njohuri të reja artistike, të cilat do t’i pasurojnë eksperiencën individuale artistike. Ndërkaq, pjesë e stafit të Akademisë do të jenë pedagogë, koreografë, ballët-maestro, dirigjentë të shquar e shumë figura profesioniste të artit të muzikës, operës e baletit.

Masterclass-i do të zhvillohet në bazën e nevoja artistike që ka TKOBAP-ja për Sezonin Artistik 2024 dhe mbi disiplinim e muzikës së dhomës **nga repertori gjerman**. Kjo me qëllim njohjen dhe përvetësimin teknik nga të rinjtë e talentuar, si në drejtim të muzikës operistike, po ashtu edhe të muzikës së dhomës.

## **QËLLIMI**

- Akademia Teatrale, si një platformë profesionale, ju jep mundësinë pjesëmarrësve të punësohen në një model aktual, të qëndrueshëm e të vazhdueshëm, me standarde të larta ndërkombëtare.
- Kjo akademi do të rikthejë në vendin tonë, një brez të ri artistësh, të barasvlershëm me investimin e bërë në edukimin e tyre.
- Mbi të gjitha, artistët e rinj do mund të pasurojnë repertorin artistik të veprave që nuk i kanë debutuar përgjatë viteve akademike apo përgjatë eksperiencës së tyre artistike.
- Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të studiojnë me disa nga figurat më të suksesshme të muzikës, duke iu siguruar një rritje të garantuar të performancës së tyre artistike.
- Në fund të kësaj eksperiencë, të rinjtë do të kenë mundësinë të pajisen me një portofol profesional, të mbushur me përvoja të vyera mjeshtërore, me të cilat do mund të konkurrojnë me bashkëmoshatarët e tyre evropianë, si dhe me ata përtej oqeanit.

## **KALENDARI**

- Aplikimi do të qëndroje i hapur nderi më 29 shkurt
- Përzgjedhja e kandidatëve potencial do të bëhet nga Komisioni i Vlerësimit sipas 2 kategorive:
  1. Regjistrim efektiv, ku kandidatët fitues do të jenë përfitues të masterclass -it
  2. Pjesëmarrje për dëgjim, ku kandidatët do të kenë mundësinë ta ndjekin masterclass-in si dëgjues dhe jo si pjesëmarrës

## **LËNDËT STUDIMORE**

- Arti dhe teknika e vokalizmit
- Arti, teknika, interpretimi dhe parimet themelore të Bel Canto-s
- Studimi i partiturës
- Historia dhe praktika interpretuese e operës
- Teknika vokale
- Fiziologjia e instrumentit vokal
- Fjalor lirik
- Teknika aktoriale dhe punëtoria e aktrimit
- Masterklasa e interpretimit
- Masterclass: Kultura e profesionit të këngëtarit të operës

## **KRITERET E PRANIMIT**

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të dërgojë jetëshkrimin (CV) e tij/ saj të përditësuar.
- Të dorëzojë një video prezantimi ku aplikuesi performon 1 arie complete.
- Të dërgojë titullin e materialit dhe emrin e autorit, me të cilin dëshiron të punojë, (bashkëngjitur të dërgojë dhe materialin).
- Aplikuesi nuk mund të jenë më pak se 17 vjeç.

## **FORMA E APLIKIMIT**

- Në aplikim video duhet të dërgohet me We Transfer në email-in zyrtar: sekretaria@tkob.gov.al
- Kandidati duhet të tregojë FORMULARIN E APLIKIMIT
- TKOB nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë problem teknik dhe/ose kompjuterik që pengon dorëzimin e saktë të formularit të aplikimit të dërguar nga kandidatët.
- Përgjigja e pranimit ose jo, në Akademinë Teatrale do të komunikohet me email nga dorëzimi i formularit të regjistrimit bashkë me videon.

## **MASTERCLASS ME DONATA D'ANNUNZIO LOMBARDI**

Soprano Donata D'Annunzio Lombardi është njohur sot një ndër interpretueset më të mëdha të muzikës pucciniane. Pas çmimit të "Albo D'oro Puccini" që mori në vitin 2015, ajo është vlerësuar edhe me çmimin prestigjioz "Puccini 2019".

Me zërin e saj të ndryshueshëm dhe aftësinë e saj të ndjeshme dhe të rafinuar interpretuese, ajo ka debutuar rolet më të rëndësishme pucciniane që nga viti 1991 deri më sot: Musetta, Mimì, Magda, Liù, Madama Butterfly, Suor Angelica, Manon Lescaut, Tosca. Ajo ka performuar në teatrot më prestigjioze në Itali dhe në të huaj, Teatro Alla Scala, Teatro Regio di Torino, Teatro Massimo di Palermo, Teatro Regio di Parma, Teatro San Carlo di Napoli, Opernhaus di Zurigo, Theatre des Champs Elisées, Theatre du Chatelet në Paris, Staatstheater di Stoccarda, Mann Auditorium në Tel Aviv, Royal house Oman, Michigan Opera Theatre etj. Ajo ka bashkëpunuar me dirigjentë si D. Oren, B. Bartoletti, Z. Peskò, J. Tate, R. E. Pidò, R. Abbado, L. Maazel, A. Veronesi, D.Renzetti, Jacopo Sipari, P. Domingo; dhe me regjisorë si F. Zeffirelli, J. Savary, W. Decker dhe P.L. Pizzi.

Ndër çmimet e shumta me të cilat është vlerësuar, ajo ka marrë edhe çmimin e parë absolut në Konkursin Ndërkombëtar të dedikuar Muzikës së Dhomës nga Francesco Paolo Tosti, Çmimin e Kritikës Domenico Danzuso, Çmimin e Këngëtares më të Mirë të vitit 2012 në Festivalin Donizetti.

## FORMULAR APLIKIMI

<b>Emër Mbiemër</b>	
<b>Datëlindja</b>	
<b>Gjinia:</b>	
<b>Adresa:</b>	
<b>Nr. Celulari:</b>	
<b>Email:</b>	
<b>Titulli i aries dhe stili:</b>	
<b>Pjesëmarrës/ Dëgjues</b>	

Unë i/e nënshkruari/a, ....., pranoj të gjitha kushtet e parashikuara nga Akademia Teatrale, organizuar nga Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe paraqes aplikimin tim për t'u vlerësuar.

**Data**

**Emër mbiemër**

**Nënshkrimi**